

# ZGJEDHJE TË REJA ME PROBLEMATIKA TË VJETRA

## **Analizë e kuadrit ligjor dhe situatës së zbatimit të tij në zgjedhjet vendore 14 maj 2023**

11 shkurt 2023

### **Vlerësime paraprake<sup>1</sup>**

Shqipëria hyri më 13 janar 2023 në periudhën 4 mujore të kufizimeve të parashikuara për përdorimin e burimeve shtetërore në zgjedhjet vendore, si dhe në shkurt përfundoi afati ligjor i propozimeve nga partitë të anëtarëve të KZAZ. Procesi po ecën në pjesën e administrimit të tij, por fatkeqësisht qytetarëve shqiptarë iu mohua edhe njëherë mundësia për të pasur një reformë zgjedhore dhe për të reflektuar së paku të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR.

Kuvendi dhe partitë dështuan të jetësojnë reformën, ndërkohë që baza ligjore aktuale në fuqi nuk i jep përgjigje disa prej shqetësimeve kryesore të shoqërisë civile dhe të grupeve monitoruese lidhur me zgjedhjet e vitit 2019 dhe 2021.

KQZ po bën përpjekje të ndikojë pozitivisht në zgjidhjen e problematikave, por në çështje thelbësore ajo nuk ka kompetenca ligjore vendimmarrëse dhe koha deri në zgjedhje mbetet e limituar për të pritur ndërhyrje emergjente ligjore. Të tilla janë keqpërdorimi i burimeve shtetërore në fushatë, keqpërdorimi i databazave me të dhëna të qytetarëve në funksion të interesave elektorale të partive, keqpërdorimi i burimeve për financim të mediave online pa ofruar transparencë mbi pronësinë dhe etikën profesionale, si dhe paqartësia lidhur me regjistrimin e subjekteve politike etj.

Akademia e Studimeve Politike në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Politike po monitoron procesin zgjedhor, në kuadër të projektit *“Partneritete të forta për reforma të qëndrueshme - Forcimi i rolit të shoqërisë civile në adresimin e sfidave të zgjedhjeve të lira dhe të drejta”*, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Shqipëri.

Ky është një raport paraprak vlerësimi mbi problematika të fazës fillestare zgjedhore, i cili i paraprin raportimeve të tjera periodike publike gjatë periudhës elektorale dhe post elektorale.

---

<sup>1</sup> Ky raport bëhet në kuadër të projektit *“Strong Partnerships for Sustainable Reforms - Strengthening the role of civil society in addressing challenges for free and fair elections”*, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta përmes programit MATRA. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi vetëm e ekipit realizues të APS & IPS; nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ambasadës.

---

## HYRJE

---

Për të ofruar zgjidhje të mundshme për mangësitë e konstatuara në proceset zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë prezantoi vendimin nr. 12/2022<sup>2</sup> dhe nr. 48/2022, për ngritjen dhe kuadrin e veprimit të Komisionit parlamentar të Posaçëm për Reformën Zgjedhore<sup>3</sup>.

Fokusi i veprimtarisë së Komisionit janë katër dokumente kryesore mbi sfidat e reformës së ardhshme zgjedhore:

- I. Raporti i OSBE/ODIHR<sup>4</sup> (2021), i cili trajtoi 5 rekomandime prioritare dhe 18 rekomandime shtesë për legjislacionin zgjedhor.
- II. Opinioni i Komisionit të Venecias<sup>5</sup> (2020), i cili dha rekomandime për 12 çështje kyçe dhe përvijoi prioritetet që duhen adresuar në reformën e re zgjedhore.
- III. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për dispozitat e Kodit Zgjedhor (2020) në lidhje me rolin e institucioneve në proceset zgjedhore.
- IV. Marrëveshja politike për Kodin Zgjedhor (05.06.2020) që ka të bëjë me ndryshimet në legjislacion para zgjedhjeve të përgjithshme të 25 prillit 2021, e cila vendos formulën e bashkëpunimit mes partive politike.

Vendimi parashikon që krahas rekomandimeve të mësipërme, të adresohen edhe rekomandimet e shoqërisë civile.

Komisioni parlamentar zhvilloi mbledhjen e parë në 10 shkurt 2022, duke dhënë shpresa se mund të aprovoheshin ndryshime të vogla ligjore me ndikim pozitiv në zgjedhjet vendore të vitit 2023. Përkundër sigurimit të frymës së nevojshme të bashkëpunimit mes mazhorancës dhe opozitës parlamentare, fatkeqësisht, kësaj herë punimet e komisionit të reformës u bllokuan kryesisht nga zhvillimet e tensionuara mes dy grupimeve që pretendojnë drejtimin e Partisë Demokratike. Kjo klimë mosbesimi solli vonesa në plotësimin e anëtarëve të Komisionit në muajt në vijim si dhe dyshimin për mandatimin e palëve negociuese të pranuar nga faktorët politikë opozitarë.

Palët nuk e përdorën kohën në dispozicion për të hartuar dhe prezantuar ndonjë draft ligjor apo amendime të ndryshme për të iniciuar debat publik përpara se Komisioni të zhvillojë mbledhje normale. Si rrjedhojë komisioni nuk arriti asnjë prej objektivave afatshkurtra të planifikuara me efekt për zgjedhjet e ardhshme vendore. Që prej fundit të dhjetorit 2022, me rrëzimin e

---

<sup>2</sup> Vendimi 12/2022:

<https://www.parlament.al/Files/Projekte/20220218103409vendim%20nr.%2012,%20dt.%2010.2.2022.pdf>

<sup>3</sup> <http://staging.parlament.al/Strukture?kategori=5&strukture=3074>

<sup>4</sup> Raporti i plotë <https://www.osce.org/files/f/documents/5/1/493687.pdf>

<sup>5</sup> Raporti i plotë [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)036-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)036-e)

kandidaturës së Avokatit të Popullit, duket se ka humbur edhe fryma e nevojshme e dialogut mes mazhorancës dhe opozitës për të mundësuar një reformë zgjedhore të gjithëpranuar.

---

## Një shans i humbur për zgjedhjet vendore

---

Në 13 janar 2023 nisi periudha 4 mujore e kufizimeve të parashikuara për përdorimin e burimeve shtetërore në zgjedhjet vendore. Në mungesën e ndryshimeve të mundshme në Kodin Zgjedhor dhe kompetencat e reduktuara të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është e pritshme që do të vijojnë të shfaqen të njëjtat problematika në zbatimin e këtyre kufizimeve.

Në rekomandimet<sup>6</sup> e dërguara për ndryshime ligjore pranë Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, në 4 tetor 2022, Komisioneri i Zgjedhjeve Ilirjan Celibashi kërkonte që të saktësoheshin kompetencat e KQZ për të zbatuar kufizimet e parashikuara në zgjedhjet e ardhshme vendore.

Më konkretisht:

### 1) Përdorimi i asetëve publike dhe fushata nga funksionarët publik

a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve aktualisht gjykon mbi raportimet e bëra nga vetë institucionet publike dhe nuk mund të monitorojë mediatizmin që iu bëhet veprimtarive me karakter publik. Kjo situatë e vendos në kushte mosveprimi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të identifikuar veprimtari me karakter publik për të cilat ka detyrim të raportohen, por ndërkohë mbeten të pa raportuara.

b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është vendosur përpara situatave të paqarta në lidhje me pjesëmarrjen në fushatë apo veprimtari të tjera publike të kryetarëve të bashkive/këshilltarëve bashkiakë, të cilët kanë edhe statusin e kandidatit.

c. Neni 91, pika 4 i Kodit Zgjedhor, ndalon 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re, propozimin miratimin ose nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë. Kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm për zgjedhjet për Kuvend dhe është e paaplikueshme për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore. (Rekomandimin e OSBE/ODIHR nr.16 viti 2021).

---

<sup>6</sup> [https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2022/10/221004\\_rekomandimet\\_e\\_kqz.pdf](https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2022/10/221004_rekomandimet_e_kqz.pdf)

## 2) Rregullat për financimin e fushatës zgjedhore.

- a. Të përcaktohen rregulla për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në median në internet (online), në rrjetet sociale dhe në median e shkruar.
- b. Të përcaktohen rregulla në lidhje me financimin dhe fushatën e subjekteve të identifikuar si “palë të treta”. (Rekomandimet e OSBE/ODIHR nr.14 viti 2019 dhe nr.18/19 viti 2021).

Këto paqartësi në zbatimin e kufizimeve dhe mungesa kompetencash të KQZ u vunë në dukje edhe nga monitorimi i Akademisë së Studimeve Politike gjatë zgjedhjeve të vitit 2021 si dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile. Aktualisht, KQZ ka nisur numërimin mbrapsht drejt datës së zgjedhjeve të 14 majit pa ndonjë konfirmim të këtyre paqartësive të ngritura në kompetencat dhe detyrat e saj.

Në pamundësi për të konfirmuar paqartësitë e mësipërme nga Kodi Zgjedhor, KQZ e vlerësoi të pamundur rishikimin e Vendimit të kritikuar nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, për rregullat e raportimit të veprimtarive të ndaluara të zyrtarëve të lartë publikë. Mungesa e përmirësimeve të mundshme krijon një lehtësi të mëtejshme për zyrtarët publikë që t’i shmangen kufizimeve të parashikuara në financimin e investimeve elektorale dhe dhënien e shpërblimeve për qytetarët që mund të kthehen në përfitime për partinë dhe kandidatët vendorë.

Është për t’u përhëndetur iniciativa e Komisionerit Celibashi për të përfshirë në kufizime mediat sociale ashtu si "mediat publike" (një prej rekomandimeve për përmirësim në Vendimin 9/2020), e publikuar në njoftimin<sup>7</sup> zyrtar drejtuar institucioneve publike qendrore dhe vendore në nisjen e periudhës 4 mujore të raportimit. Megjithatë, kjo iniciativë, e paqartësuar zyrtarisht në interpretimin e akteve të Vendimit 9/2020, ka shumë gjasa që mund të rrëzohet përsëri nga vendimmarrja e Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) në rast të apelimit të sanksionit që mund të vendoset nga Komisioneri për raste të raportuara.

---

## Administrata gjatë fushatës

---

Sipas Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore zyrtare duhet të fillojë 30 ditë përpara ditës së votimit (14 prill), por ashtu siç është vënë re në zgjedhjet e mëparshme, aktivitetet elektorale të kandidatëve nisin rreth dy muaj përpara kësaj periudhe. Më i dukshëm është ky fenomen në

<sup>7</sup> Njoftimi i plotë: [https://kqz.gov.al/2023/01/12/kujtese-mbi-veprimtarine-e-institucioneve-publike-kater-muaj-perpara-dates-se-zgjedhjeve/?fbclid=IwAR3hIN6F7DZyegokxKKXYUËKjGONPPRx\\_MU2eQIAQËcKCi9pqvKTniocko](https://kqz.gov.al/2023/01/12/kujtese-mbi-veprimtarine-e-institucioneve-publike-kater-muaj-perpara-dates-se-zgjedhjeve/?fbclid=IwAR3hIN6F7DZyegokxKKXYUËKjGONPPRx_MU2eQIAQËcKCi9pqvKTniocko)


rastin e zgjedhjeve vendore, kur kryetarët e bashkive në kandidimin dhe stafet e tyre orientojnë të gjitha aktivitetin e tyre në funksion të zgjedhjeve. Zgjedhjet e 14 majit përbëjnë një risi në faktin që për herë të parë do të jetë e përqendruar pushteti qendror dhe ai vendor në të gjitha bashkitë e vendit nën të njëjtën forcë politike.

Në zgjedhjet e fundit pati raportime të nëpunësve civilë të përfshirë në aktivitete elektorale si dhe nxitje për të votuar partinë në pushtet. Njëkohësisht numri i punonjësve shtetërorë, shënoi një rritje të dukshme në periudhën e fushatës zgjedhore. Më konkretisht, shifrat zyrtare të INSTAT, dëshmuar një numër rekord të punësuarish (185.392 persona), ose 2,845 më shumë të punësuar në periudhën parazgjedhore.

Në të dhënat e fundit të ofruara nga INSTAT, vihet re një ulje e numrit të punonjësve shtetërorë në tremujorin e tretë të vitit 2022, në vlerën 182.160 të punësuarish. Mbetet për t'u verifikuar sa do të ndryshojë kjo vlerë në tremujorin e parë të këtij viti, në periudhën parazgjedhore, kur zakonisht vihet re një rritje e punësimeve. Me një rregullore të re të INSTAT, statistikat e punësimit në sektorin shtetëror publikohen në bazë vjetore, me qëllim për të evituar pasaktësi. Si rrjedhojë, të dhënat e punësimit gjatë fushatës aktuale zgjedhore do të jenë të disponueshme në përfundim të vitit 2023.

Tabela e mëposhtme pasqyron të dhënat e INSTAT deri në vjeshtën e vitit 2022

Periudha (3 mujoret)	2020-1	2020-2	2020-3	2020-4	2021-1	2021-2	2021-3	2021-4	2022-1	2022-2	2022-3
<b>Të punësuar në sektorin shtetëror</b>	174,227	173,022	171,975	182,547	183,929	185,392	180,121	183,578	184,205	185,696	182,160



Grafiku mbi databazën statistikore INSTAT

Me VKM nr. 56<sup>8</sup>, datë 1.2.2023, Këshilli i Ministrave përcaktoi gjithashtu 2.671 punonjës me kontratë të përkohshme për vitin 2023 në njësitë e qeverisjes qendrore. Këto pozicione pune janë edhe më të rrezikuara nga përdorimi për përfitime politike në prag të fushatës zgjedhore.

Për të evituar përdorimin e administratës në fushatë dhe presionet që janë denoncuar në zgjedhjet e mëparshme, Kodi Zgjedhor parashikon kufizime për sjelljen e administratës shtetërore në periudhën parazgjedhore.

Më konkretisht, kufizimet përcaktojnë si më poshtë vijon:

#### Kufizimet për administratën shtetërore - NDALOHET

- *Përdorimi i detyruar në fushatën zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore. [Neni 91, pika 2]*
- *Premtimi ose ofrimi i përfitimeve ndaj nëpunësve publike, ose studentëve për të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me fushatën jashtë orarit të punës ose shkollës ose të ushtruarit e presionit mbi to për këtë qëllim. [Neni 91, pika 2]*
- *Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara. [Neni 91, pika 3]*

Bazuar mbi kufizimet e Kodit Zgjedhor, më 8 mars 2021, **Departamenti i Administratës Publike** (DAP) hartoi një dokument të brendshëm / Memo për të qartësuar ndalime/kufizime/detyrime për nëpunësit/punonjësit civilë të institucioneve të administratës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore. Dokumenti nënvizoi më tej detyrimet e nëpunësve civilë pjesë e këtyre institucioneve për:

- Nëpunësit civilë që kandidojnë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, detyrohen të kërkojnë pezullimin nga detyra.
- Nëpunësve civilë të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, u ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.

<sup>8</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave - <https://qbz.gov.al/share/06AYtbB0Q8m7YvnmADC6Q>

- Nëpunësit civilë nuk mund të shprehin publikisht bindjet apo preferencat e tyre politike gjatë ushtrimit të detyrës apo gjatë pjesëmarrjes në veprimtari politike apo zgjedhore dhe nuk mund të bëjnë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat.
- Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve kur; (i) lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës; (ii) marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.
- Gjatë fushatës zgjedhore ndalohen shtesat në organikën e çdo institucioni publik apo entet publike apo emëtime provizore në to.

Gjithashtu, **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC)**, në shkresën nr. 458, datë 05.04.2021, drejtuar grupeve të monitorimit të burimeve njerëzore të institucioneve pjesë e shërbimit civil, interpretoi më tej këto kufizime duke e shtrirë fushën e tyre të veprimit edhe në mediat sociale. Sipas përcaktimit të Komisionerit: “... **ndarja apo pëlqimi i materialeve elektorale të subjekteve politike në mediat sociale (Facebook, Twitter, Instagram) në llogaritë personale të punonjësve civilë përbën shkelje të detyrimit për të mos shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tyre politike**”. Ky interpretim i kufizimeve nga Komisioneri për të kufizuar preferencat politike edhe në llogaritë personale sociale të punonjësve civilë ishte pasojë e presionit në të cilin ndodheshin punonjësit për të ndarë aktivitetet elektorale të drejtuesve të tyre institucionalë.

Përkundër këtyre kufizimeve për pëlqimet dhe ndarjet të materialeve politike nga punonjësit e administratës, në ditët e para të janarit mediat<sup>9</sup> denoncuan rritjen e presionit ndaj administratës nëpërmjet krijimit të aplikacionit “Aktivist” nga Partia Socialiste. Qëllimi kryesor i aplikacionit është rritja e ndërveprimit të përdoruesve për të pëlqyer, shpërndarë dhe komentuar në mediat sociale të aktivitetit të kryeministrit Rama, ministrave dhe kreut të bashkisë së Tiranës Erjon Veliqaj. Në bazë të komenteve dhe pëlqimeve që një përdorues bën në postimet e zyrtarëve socialistë, ai vlerësohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi që është publik. Është normale të dyshohet se ky sistem pikëzimi është një mënyrë për të vlerësuar edhe angazhimin e anëtarëve të PS dhe jo vetëm, të cilët janë pjesë përbërëse e punonjësve të administratës shtetërore.

---

<sup>9</sup> “Aktivist”/ Shtohet presioni mbi administratën para fushatës së 14 Majit  
<https://lapsi.al/2023/01/13/administrata/>

Një rrjedhje e emrave të përdoruesve të aplikacionit ditët e fundit, nxiti më tej dyshimet për një angazhim falë aplikacionit të nëpunësve shtetërorë, anëtarë të PS dhe jo vetëm, në promovimin online të veprimtarisë politike të ministrave. Nuk disponohet ende një dokument zyrtar, por në variantin e listës<sup>10</sup> së publikuar nga Citizen Channel, mes 6.372 përdoruesve të regjistruar me identitetin e plotë në aplikacionin “Aktivist” janë deklaruar si përdorues sekretarë të përgjithshëm, drejtorë drejtorie, specialistë të nivelit të lartë, por dhe gjyqtarë, prokurorë, policë, ushtarakë apo mjekë dhe arsimtarë. Mediat kanë denoncuar gjithashtu faktin se mes kryesuesve të renditjes së pikëve të mbledhura në aplikacion, gjenden punonjës të administratës publike, deri me 24,000 pikë të grumbulluara. Kjo vlerë pikësh është barabartë me klikimin e 4,800 postimeve në rrjetet sociale të aktiviteteve të kabinetit qeveritar, një angazhim që kërkon kohë nga dita e një punonjësi shtetëror.

Me nisjen e fushatës zgjedhore (14 prill 2023), bazuar në interpretimin e kufizimeve të Kodit Zgjedhor nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), përdorimi i këtij aplikacioni përbën nxitje nga ana e Partisë Socialiste për shkelje administrative të nëpunësve/punonjësve civilë të administratës shtetërore. Është e nevojshme që në nisje të fushatës zgjedhore, Partia Socialiste të pezullojë përkohësisht në aplikacion llogaritë e përdoruesve në pozicionet e administratës publike, të parashikuara në kufizimet e Kodit Zgjedhor.

Pas skandalit të publikimit të databazës së patronazhistëve në zgjedhjet e kaluara, është për të ardhur keq që kjo rrjedhje e të dhënave personale të aplikacionit Aktivisti po kalon në heshtje nga institucionet ligjzbatuese dhe po keqpërdoret për betejat politike të ditës. Një hetim i thelluar i vërtetësisë së listës së publikuar, por edhe shqetësimeve për ruajtjen e të dhënave dhe mënyrën si rrodhi lista është e domosdoshme për të larguar çdo dyshim si dhe për të siguruar klimën e nevojshme të besimit mes aktorë në vigjilje të nisjes së një fushatë të nxehtë zgjedhore.

---

## Zbatimi i kufizimeve të deritanishme nga KQZ

---

Në 13 janar 2023, me nisjen e afatit 4 mujor të kufizimeve për burimet shtetërore, KQZ vuri në kohën e duhur në dispozicion ndërfaqen për raportimin e veprimtarive publike të institucioneve publike ([aktivitete.kqz.gov.al](https://www.aktivitete.kqz.gov.al))

---

<sup>10</sup>Lista e Aktivist- <https://www.hashtag.al/index.php/2023/02/08/del-ne-rrjet-dokumenti-me-266-faqe-dyshohet-se-ka-emrat-e-zyrtareve-te-administrates-qe-kane-shkarkuar-aplikacionin-aktivisti-te-ps-se/>



Sipas KQZ, në periudhën 13 janar – 4 shkurt rezultojnë:

- a. 524 institucione të regjistruara në ndërfaqen e raportimeve;
- b. 819 veprimtari të raportuara;
- c. 109 raportime nuk kanë respektuar afatin për raportim (jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë publike;
- d. 0 veprimtari publike të raportuar dhe të ndaluar nga KQZ.

Një zhvillim pozitiv nga KQZ në këto zgjedhje është zhvillimi pa vonesa i hetimit administrativ mbi shkeljet e konstatuara për vonesa në raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, qendrore dhe vendore. Në mbledhjen<sup>11</sup> e datës 8 shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi sanksionet e para administrative për periudhën 20 Janar- 23 Janar 2023 ndaj personit përgjegjës për raportim në bashkinë Durrës dhe bashkinë Berat (në vlerën 10 mijë lekë).

Rekrutimi i 120 monitoruesve në terren të KQZ, të cilët mund të zhvillojnë monitorimin e veprimtarive publike në fushatë, nisi në kohën e duhur dhe trajnimi i tyre u zhvillua në ditët e fundit të janarit sipas një plani<sup>12</sup> të publikuar me transparencën e duhur nga KQZ. Me gjithë trajnimin në kohë, mbetet ende një sfidë për KQZ që të sigurojë një mbikëqyrje efektive të aktiviteteve elektorale në terren nga monitoruesit (zyrat elektorale, respektimin e kufizimeve për kostot e materialeve propagandistike, kostot e mitingjeve etj) si dhe që raportet e tyre të mos përsërisin kufizimet e mëparshme për sa i përket objektit, analizimit dhe qartësisë.

## 11 shkurt 2023

AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE  
Rr. Emin Duraku, Pallati Credins, kati 7, Tiranë  
Tel: +355 4 5629047, E-mail: info@asp.al  
Web: www.asp.al

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE  
Rr. Luigj Gurakuqi, Shk. A, P.89 K.3, Tiranë  
Email: contactaips@isp.com.al  
Web: www.isp.com.al

<sup>11</sup> <https://kqz.gov.al/2023/02/06/njoftim-per-zhvillimin-e-seances-publike-nga-komisioneri-shteteror-i-zgjedhjeve-ne-daten-08-02-2023/>

<sup>12</sup> <https://kqz.gov.al/2023/01/23/zgjedhjet-e-dates-14-maj-nis-trajnimi-i-monitoruesve-te-fushates-zgjedhore/>